

Republika e Kosovës

Komuna e Vushtrri

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Në bazë të nenit 7, pika 1.1, 1.3 dhe 1.4, nenit 12 pika 2 dhe 4 të Ligjit Nr. 03/L-145 për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë, nenit 3, nenit 4 dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 11/2010 për Licencimin e Qendrave Rinore, Komuna e Vushtrrisë – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, më datë 19 tetor 2020, shpall:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

PËR LICENCIM SI QENDËR RINORE PUBLIKE NË VUSHTRRI

Ftohen të gjithë përfaqësuesit e OJQ - ve lokale të Vushtrrisë, të cilat fushëveprimtarinë e tyre kryesore e realizojnë në sektorin e rinisë, të aplikojnë për licencimin e Qendrës Rinore Publike në Komunën e Vushtrrisë.

Kushtet për Licencim:

- Kërkesa për Licencim e Qendrës Rinore Publike;
- Certifikata e vlefshme e regjistrimit si OJQ e regjistruar në Ministrinë kompetente
- Statutin i Organizatës;
- Plani i punës dhe programi për së paku dy vjet;
- Raportet e aktiviteteve të mëparshme dhe hapësira e veprimtarisë;
- Biografitë e personelit menaxhues të OJQ-së;
- Dëshmi mbi strukturën organizative të brendshme dhe funksionimin e Kuvendit të Anëtarëve;
- Personel menaxhues, personel edukativ, mirëmbajtës;
- Strukturë vullnetare, regjistri i anëtarëve;
- Kohë të operimit (orari i punës);

- Rend shtëpiak;
- Numër të konsiderueshëm të të rinjëve që marrin pjesë në aktivitete;
- Marrëveshjen e shfrytëzimit e hapësirës/objektit për periudhën që kërkon të licençohet.

Vërejtje:


Kërkesat e arritura pas afatit nuk do të shqyrtohen, kurse dokumentacioni i pakompletuar do të refuzohet.

Hapësira e dedikuar për licencim si Qendër Rinore është kati i parë i objektit të Qendrës Rinore “Naxhije dhe Fahri Buçinca”, me mundësi shfrytëzimi të dy sallave, sipas nevojës së Qendrës Rinore që licençohet.

Dokumentacioni për konkurim dorëzohet në zyrën pritëse të komunës.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë pune nga dita e shpalljes në webfaqen e Komunës dhe në hapësirat publike.

Për informata shtesë mund të kontaktoni te udhëheqsi i sektorit të rinisë, në DKRS, Liridon Hajdini, në e-mail adresën: liridon.hajdini@rks.gov.net apo liridoh@gmail.com



Drejtoreshë e DKRS-së

Fatmire Cecelia